



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

“ PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM 2020-2022”

❖ Vështrim i përgjithshëm mbi Bashkinë Gjirokastrë.

Bashkia Gjirokastrë administron një sipërfaqe prej 478 Km² dhe ka një popullsi prej 52.000 banorësh sipas gjendjes civile. Në zbatim të ligjit 115 “Për reformën administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverrises vendore në Republikën e Shqipërisë” Bashkia Gjirokastrë përbëhet nga Njësia Administrative qytet dhe gjashtë njësi të tjera të cilat janë: Njësia Administrative Picar, Njësia Administrative Cepo, Njësia Administrative Lunxhëri, Njësia Administrative Lazarat dhe Njësia Administrative Odrie dhe 31 fshatra. Në zbatim të ligjit 115 “Për reformën administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverrises vendore në Republikën e Shqipërisë” Bashkia Gjirokastrë është rritur si në sipërfaqe ashtu edhe në funksione. Për përmbushjen e objektivave të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj komunitetit Bashkia Gjirokastrë funksionon në zbatim të ligjeve prej të cilëve janë hartuar metodologji dhe udhëzime të brendshme të cilat garantojnë konsolidim të vlerësimit të të ardhurave dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve në komunitet.

Bashkia Gjirokastrë ushtron funksionin e saj në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor të cilat janë si më poshtë:

Politikat e PPV për sistemin bujqësor parashikojnë ruajtjen, konsolidimin dhe modernizimin, si :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

- Mbrojtjen maksimale të tokës bujqësore duke propozuar densifikimin e zonave urbane.
- Krijimi i një zinxhiri ekonomik bujqësor që nga prodhimi, grumbullimi, përpunimi e tregtimi (treg rajonal bujqësor). Nevojitet bashkëpunimi i fermerëve.
- Ulja e kostos së produkteve dhe shtimi i investimeve për modernizimin e teknologjisë dhe infrastrukturat përkatëse. Krijimi i rrjetit të kanaleve vaditëse e kulluese për tokat bujqësore.
- Sinergjia me sektorë të tjerë, si p.sh. turizmi, transporti, energjia.
- Krijimi i Poleve Bujqësore dhe specializimi sipas rastit. Gjirokastra ka afër polin e propozuar bujqësor të Sarandës, nga i cili mund të përfitojë.
- Çertifikimi i produkteve karakteristike vendase dhe specializimi në prodhimi dhe përpunim (si bimët mjekësore, pemët frutore, ullishtet, vreshtat, produkte bujqësore). Prodhimi i produkteve bio (organike) dhe nxitja e funksionimit të fermave do të rriste konkurueshmërinë e këtyre produkteve në rajon. Për sistemin ujor propozohen politikat për:
 - Përdorimin racional dhe i qëndrueshëm i burimeve ujore.
 - Përmirësimi i teknologjive dhe jo përdorim intensive i burimeve ujore.
 - Uljen e mbetjeve të prodhuara.
 - Ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve natyrore.
- Plotësimin e nevojave për përdorimin e ujit të pishëm, në bujqësi dhe për prodhim energjie. Menaxhimin e qëndrueshëm të këtyre kërkesave. Hartimi i planeve të menaxhimit të trupave ujorë (veçanërisht baseni i lumit Vjosa).
- Mbrojtjen e burimeve ujore përmes përcaktimit të Vijës Blu nga përdorimet e ndaluara dhe shfrytëzimi privat (200 m nga bredgeti, 100 m nga lumi, 1 km nga korridoret natyrore). Të trajtohet si zone e mbrojtur dhe mbi të të respektohet legjislacioni në fuqi.
- Pajisjen me impiant të trajtimit të ujërave të ndotur të qendrave parësore e dytësore (minimalisht 1).



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR**

- Mbulimi i plotë i zonave turistike e suburbane me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve.

Për sistemin natyror synohen politikat për:

- Mbrojtjen e mjedisit natyror në mënyrë të qëndrueshme.
- Rritjen e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në nivel kombëtar duke u bërë pjesë e Korridorit të Gjellbër European dhe Harkut Dinarik Ekorajonal. Aktualisht sipërfaqja e zonave të mbrojtura në Shqipëri është 15 % dhe synohet të shkohet në 20 % në tokë e 15% në det. Gjithashtu integrimi në rrjetin “Natura 2000” do të rrisje shkallën e ruajtjes së peisazhit natyror dhe biodiversitetit.
- Integrimin e sistemit natyror në zinxhirin e ekonomisë vendase si aset me vlerë. Kështu do të mund të përthitheshin më mire burimet financiare vendase dhe të huaja. Gjithashtu mund të nxitet pyllëzimi aty ku tokat bujqësore nuk janë pjellore, apo krijimi i parqeve eolike ose fotovoltaike në rastin e tokave jo të mira bujqësore.
- Përmirësimin e cilësisë së jetës përmes rritjes së aksesueshmërisë ndaj zonave natyrore, por gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme.
- Krijimin e hapësirave rekreative përgjatë luginave të lumenjve dhe krijimin e Korridoreve Natyrore përgjatë tyre.
- Përmirësimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve për kufizimin e ndotjes së ujrave.
- Hartimin dhe zbatimin me rigorozitet i planeve të menaxhimit të ujërave, pyjeve, ajrit dhe mbetjeve (riciklimi).
- Mundësi për prodhimin e energjisë së rinovueshme.
- Zhvillimin e një sistemi transporti të plotë dhe miqësor ndaj mjedisit, i cili do të sigurojë qasje dhe lidhje me brendësinë e vendit dhe lidhje me rajonin Ballkanik dhe atë Evropian. Këtu listohen transporti publik, hekurudhor, detar e ajror.
- Zhvillimin e rrjetit të komunikimit përmes përmirësimit të telekomunikacionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

- Gjirokastra gjendet pranë korridoreve rrugore tërthore mbështetëse të propozuara Himarë-Këlcyrë-Përmet-Kakavijë dhe Sarandë-Kakavijë.
- Gjirokastra është pjesë e Aksit Lindje-Perëndim lidhës me Janinën.
- Krijimi i itinerareve alternative për rrugë këmbësore e biçikleta.
- Mundësia e diversifikimit të energjisë përmes përdorimit të energjisë së rinovueshme apo alternativave të tjera.
- Lidhja e zonave turistike malore me ato bregdetare përmes lidhjes së qendrave Kardhiq-Fterë.

Parashikohet respektimi i rregulloreve ndërkombëtare për sitet që janë pjesë e UNESCO-s siç është Gjirokastra. Për sa i përket zhvillimit urban, përsëriten objektivat kryesore të përcaktuara nga PPK lidhen me zhvillimin policentrik dhe reduktimin e shpërndarjes urbane. Propozohen gjithashtu forcimi i qendrave lokale dhe të specializuara të banimit në brendësi rimëkëmbja/ rigjenerimi i strukturës urbane, etj.

Përmirësimi i qasjes dhe forcimi i infrastrukturës, me theks format e buta përbëjnë drejtimet themelore në sektorin e infrastrukturës. Në sektorin e energjisë, propozohet përdorimi i energjisë së rinovueshme, promovimi i përdorimit të materialeve të ndërtimit për eficiencën e energjisë, zgjerimi i rrjetit për linja të reja etj. Forcimi i sipërmarrjes lokale, përdorimi dhe vlerësimi i qëndrueshëm i karakteristikave dhe burimeve lokale etj., propozohen si drejtime themelore për nxitjen e ekonomisë. Theksohet në mënyrë specifike nxitja e turizmit, me politika të tilla si zhvillimi i butë turistik i burimeve kulturore, natyrore etj, kombinimi i traditës me format moderne, rrjetet tematike, etj Gjithashtu, theksohet në mënyrë specifike sektori i bujqësisë, me synim themelor promovimin e produkteve tradicionale dhe kombinimin i traditës vendase me format moderne, sinergjinë e prodhimit bujqësor me turizmin dhe ekonominë e shkallës. Së fundi, një komponent kyç i projektit të propozuar është mbrojtja e mjedisit natyror, me fokus bregdetin, ekosistemet pyjore dhe burimet ujore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Sistemi Territorial Natyral

Bashkia Gjirokastrë është e pasur veçanërisht në burime natyrore. Është për tu theksuar se brenda kufijve të saj është lokalizuar zona rreptësisht e mbrojtur e Kardhiqit, e cila është duke u përfshirë në rrjetin europian “Natura 2000”. Gjithashtu, brenda kufijve të Bashkisë janë identifikuar 15 elementë mjedisesh natyrore të cilat mbrohen në bazë të VKM nr. 676, datë 20.12.2002 dhe përfshijnë ndër të tjera, pemë, kanione, liqene dhe vende të tjera me vlera ekologjike dhe bukuri natyrore. Një pjesë e madhe e territorit të Bashkisë është e mbuluar me toka shkëmbore dhe kullota. Megjithatë, në disa vende ka edhe pyje, të cilat kanë arritur të ruajnë karakterin e tyre, kryesisht për shkak të mungesës së aktivitetit njerëzor afër tyre. Në Bashkinë e Gjirokastrës dhe në disa vende të ndryshme (p.sh në afërsi të vendbanimeve Picar, mbi Gerhot, midis Gjirokastrës dhe Lazaratit), gjenden gurore të gurëve gëlqerorë, ndërsa në 2-3 vende rreth Fushëbardhës ka miniera fosforiti. Rreziqe direkte të degradimit të mjedisit natyror identifikohen psh degradim vizual për shkak të hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve si dhe rreziku i shkatërrimit për shkak të zjarreve dhe ndotjes së përhapur. Në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit natyror të gjithë territorit shqiptar, aplikohet Plani i Përgjithshëm Kombëtar PPK si edhe Plani Strategjik mbi biodiversitetin, në të cilin përcaktohet objektivi i rritjes së zonave të mbrojtura në 17% të territorit të vendit dhe paralelisht hartimin e planeve për menaxhimin e këtyre zonave. Realizimi i këtij qëllimi mund të mbrojë këto zona nga aktivitete ekonomike të papajtueshme dhe të padëshiruara, por edhe të çojë drejt një studimit shfrytëzimi në formë të butë (p.sh turizëm mjedisor) që mund të stimulojë mjedisin ekonomik dhe të sjellë të ardhura të rëndësishme për Bashkinë. Për më tepër, sipas Planit të Integruar NdërSektorial për Bregdetin (PINS_Bregdeti) propozohet mbështetje me forma alternative të turizmit, të tilla si ekoturizmi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Sistemi Territorial Ujor

Sistemi hidrografik në Bashkinë e Gjirokastrës është i shtrirë dhe përfshin, përveç lumit Drino i cili është organi kryesor ujor që e përshkruan, një rrjet burimesh, lumenjsh, liqenesh dhe rezervuarësh. Burimet, si për shembull Hosi, në veri të fshatit Kakoz, sigurojnë ujë me cilësi shumë të mirë. Tregues i cilësisë së mirë të ujit në rajon është ekzistenca e shumë fabrikave të mbushjes së ujit mineral si Glina, Trebeshina, Çajupi etj. Megjithatë vlen të përmendet se sistemi hidrologjik ndodhet nën presion të fortë si për shkak të rritjes së urbanizimit por edhe për shkak të menaxhimit të keq të depozitimeve ekzistuese nëpërmjet depozitimit të mbetjeve urbane të papërpunuara dhe mbetjeve industriale në lumin Drino, aktivitetëve tregtarë përgjatë lumit dhe në përgjithësi mos mbrojtjes së të gjithë sistemit nëpërmjet projekteve të duhura teknike. Faktorë të tjerë negativë janë rritja e aktivitetit të nxjerrjes së rërës dhe depozitimi i mbetjeve të ngurta në lumin Drino në vende të papërshtatshme. Sistemi hidrologjik është nën presion edhe nga varrezat që ndodhen në afërsi të rrjedhave dhe rrezikon ndotjen e akuiferit. Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) nxit mbrojtjen e burimeve ujore nga nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit, nga shkarkimi i mbetjeve urbane dhe nga ndotja nga aktivitete bujqësore dhe industriale me anë të përcaktimit të së ashtuquajturës vijës blu (blue line). Gjithashtu, parashikohet si prioritet modernizimi dhe fuqizimi i infrastrukturës ujore dhe ujitëse ekzistuese për të minimizuar humbjet e rrjeteve dhe të çojë vendin drejt menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve.

Sistemi Territorial Bujqësor

Zonat bujqësore brenda kufijve të Bashkisë paraqesin një përqendrim të lartë në luginën e lumit Drino. Ka të bëjë kryesisht me të mbjella të ujitura foragjere. Në zonat më malore, shohim, vreshta në distancë të afërt nga vendbanimet, si edhe të mbjella me bimë terapeutike dhe aromatike, të cilat ose janë për përdorim vetjak ose për shitje. Sistemi i tokës bujqësore ka disa dobësi të rëndësishme, të cilat lidhen si me morfologjinë e tokës (rreth 60% e sipërfaqes totale nuk është drejtpërdrejt e shfrytëzueshme për përdorim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

bujqësor për shkak të shpateve mbi 15%) por edhe me probleme ekzistuese që lidhen me faktorë njerëzor dhe kushtet ekonomike, bashkëjetesa e përdorimeve bujqësore me ato industriale, banimi etj, mungesa e mjeteve moderne të prodhimit dhe korrjes si dhe mungesa e standardizimit dhe promovimit të produkteve. Presioni mbi tokën bujqësore nuk ka të bëjë vetëm me Bashkinë e Gjirokastrës por në përgjithësi me të gjithë territorin shqiptar pasi vërehet një kthesë nga sektori primar dhe sekondar drejt sektorit të shërbimeve. Prandaj, Plani i Përgjithshëm Kombëtar vendos si prioritet mbrojtjen maksimale të tokës bujqësore nëpërmjet reduktimit të shtrirjes urbane, si dhe zhvillimit teknologjik të prodhimit bujqësor.

Sistemi Territorial Urban

Popullsia e kësaj Bashkie në vitet 2001 deri në 2011 u zvogëlua në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me regjistrimet e mëparshme (1989 dhe 2001), kryesisht për shkak të migrimit të banorëve në moshë të re drejt qyteteve të tjera por edhe jashtë vendit në kërkim të një pune dhe kushteve më të mira jetese. Prandaj, vërehet edhe plakja graduale e popullsisë. Megjithatë, në kontrast me këtë fakt, Gjirokastra është një qendër e rëndësishme urbane e Shqipërisë dhe gjithashtu një destinacion turistik ndërkombëtar, kryesisht për shkak të faktit se është klasifikuar si Qyteti Monument i Trashëgimisë Kulturore nga UNESCO. Është gjithashtu një qendër e rëndësishme e tregtisë ndërkufitare, kryesisht me Greqinë, nëpërmjet stacioneve doganore të Kakavijës dhe Gjirokastrës. Pakësimi dhe plakja e popullsisë është më e theksuar në vendbanimet më të largëta, fakt ky që fsheh rrezikun e shkretimit të tyre. Megjithatë, vlen të përmendet se një pjesë e konsiderueshme e banorëve të kësaj Bashkie (rreth 70%) është në moshë produktive, mes 15 me 64 vjeç dhe ka një nivel të lartë arsimor (kanë përfunduar shkollën e mesme dhe të lartë) fakt që e bën atë shumë konkurrues në fushën e punësimit. Niveli i lartë i arsimit të tyre mund të justifikohet me rritjen e infrastrukturës arsimore por edhe me ekzistencën e Universitetit “E. Çabej” në qytet. Në përgjithësi, qyteti i Gjirokastrës ka një përqëndrim të lartë të shërbimeve (p.sh Gjykata e Shkallës së Parë, Prokuroria,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Hipoteka, Shërbime të administratës publike etj) si edhe zonë sportive e kulturore (p.sh bibliotekë, kinema, shkollë muzike etj). Nga ana tjetër, nuk ka infrastrukturë të ngjashme në vendbanimet rajonale, të cilët për këto shërbime i drejtohen qytetit të Gjirokastrës. Përgjatë autostradës SH4 dhe në afërsi të saj, vërehet një përqëndrim i lartë i njësive industriale dhe prodhuese, por shumë prej tyre nuk janë aktive. Njësitë industriale shpesh janë afër me zona të banuara duke krijuar konflikte në përdorimin e tokës. Ky është rezultat i mungesës për një kohë të gjatë i planifikimit urban por edhe i industrializimit dhe urbanizimit intensiv, që u bë kryesisht përmes ndërtimit të paligjshëm pa u marrë parasysh kriteret e nevojshme teknike, sociale dhe mjedisore. Një tjetër shëmbull i konfliktit të shfrytëzimit të tokës është prania e fermave të vogla blegtorale brenda vendbanimeve dhe që janë burime të mundshme ndotjeje. Për sa i përket ndërtesave, shumë prej tyre me arkitekturë tradicionale në qendrën historike të Gjirokastrës kanë pësuar dëme të konsiderueshme por edhe ato të vjetra të ndodhura në vendbanime të ndryshme. Si rezultat rreth 28-52% e ndërtesave në njësitë përkatëse administrative janë tashmë të pabanueshme. Në shumë raste është parë zëvendësimi i ndërtesave të vjetra me më reja të mëdha dhe me arkitekturë të papërputhshme, të cilat çojnë në ndryshimin e fizionomisë së vendbanimeve. Gjithashtu, siç u përmend, një numër i konsiderueshëm i ndërtesave industriale janë braktisur ose kanë pësuar dëme të mëdha për shkak të mungesës së mirëmbajtjeve. Në të gjithë territorin e bashkisë së Gjirokastrës vërehet mungesa e hapësirave publike. Kjo pjesërisht për shkak të mungesës të tokës publike e komunale dhe pjesërisht për shkak të mos shfrytëzimit të ish njësive ushtarake (p.sh Gërhót, Kordhocë, Antigonë) për të siguruar hapësirat e nevojshme.

Për sa i përket të ardhmes së bashkisë së Gjirokastrës, Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) ofron një kornizë të re për planifikimin territorial, i cili integron udhëzimet bazë europiane për sigurimin e kohezionit territorial dhe të decentralizimit të sistemit të vendimmarrjes. Qyteti i Gjirokastrës njihet si një prej 9 qendrave urbane të nivelit të parë, për të cilin propozohet fuqizimi me infrastrukturë teknike dhe sociale. Gjithashtu, zona e studimit do të përbëjë një pjesë të rajonit të pavarur ekonomikisht Gjirokastrë-Sarandë dhe do të forcohet më tej në sektorin e shërbimeve, që të jetë në gjendje të mbulojë edhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

nevojat përkatëse të anës bregdetare. Së fundi, propozohet bashkëpunimi ndërkufitar i qytetit të Gjirokastrës me qytetin e Janinës në Greqi për të rritur tregtinë dhe bashkëpunimin mes dy shteteve, duke fuqizuar rolin e të dy qendrave urbane në rajon. Megjithatë vlen të përmendet se ekziston rreziku që qyteti i Gjirokastrës të mos jetë në gjendje të arrijë nivelin e dëshiruar të zhvillimit dhe për këtë arsye të privohet në krahasim me qendrat fqinje të specializuara, p.sh Saranda. Gjithashtu, duhet të trajtohen ndërtimet e paligjshme që çojnë në shtrirjen e pakontrolluar urbane, problemet në bashkëjetesën e përdorimeve kontradiktore të përdorimeve të tokës brenda vendbanimeve dhe çështjen e ndërtesave të braktisura industriale, pasi këto ndikojnë në krijimin e zonave inaktive pavarësisht se në thelb kanë vlerë të lartë toke. Vëmendje të veçantë i duhet dhënë gjithashtu edhe menaxhimit të programeve të rehabilitimit dhe promovimit të qendrës historike të qytetit të Gjirokastrës pasi mund të çojnë në braktisjen e përdorimit të banesave brenda zonës së përcaktuar nga UNESCO. Së fundi, theksohet së zhvillimi i mëtejshëm i qytetit të Gjirokastrës duhet të eci bashkë me zhvillimin e vendbanimeve periferike të Bashkisë, në të kundërt do të ketë presion demografik në to për shkak të migrimit të brendshëm drejt qendrës urbane, në kërkim të kushteve më të mira të jetesës.

Sistemi Territorial Infrastruktural

Sistemi i infrastrukturës mund të ndahet në dy nënsisteme kryesore, atë të transportit dhe atë të rrjetit të shërbimeve. Për sa i përket rrjetit të transportit, infrastruktura kryesore është autostrada SH4 që kalon përmes bashkisë së Gjirokastrës me gravurë paralele me lumin Drino. Praktikisht, bëhet fjalë për rrugën që lidh pjesën veriore më atë jugore të vendit dhe përbën Portën Jugore të Shqipërisë drejt Greqisë. Autostrada SH4 është, gjithashtu, pjesë e korridorit Evropian Route 2C, të transportit të Europës juglindore. Pjesa tjetër e rrjetit rrugor, përveç SH4, nuk është në gjendje të mirë. Rrugët e asfaltuara kufizohen brenda qytetit të Gjirokastrës dhe midis kryqëzimeve të autostradës SH4 që të çojnë në periferi të vendbanimeve të tjera. Theksohet se për shkak të terrenit të veçantë të zonës së studimit ka vështirësi veçanërisht në projektet rrugore. Ky fakt ka krijuar tashmë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

një çekuilibër në shkallën e aksesit midis vendbanimeve periferike që ndodhen në pjesën lindore të bashkisë (njësia administrative Odrie, Lunxhëri, Antigone) dhe ato që ndodhen në pjesën perëndimore (njësia administrative Cepo, Picar).

➤ **OBJEKTIVAT STRATEGJIKE**

Për të përmbushur vizionin Bashkia Gjirokastrës nëpërmjet PPV të miratuar në Shtator 2017 ka zhvilluar 5 objektiva strategjike, të cilat do të udhëheqin zhvillimin në të gjithë territorin e Bashkisë për vitet në vijim. Këto objektiva paraqiten si më poshtë vijon:

Objektivi Strategjik 1: Forcimi i pozicionit kyç të Bashkisë, për tu bërë porta jugore e vendit dhe nyje për bashkëpunimin ndërkufitar. Duke forcuar në të njëjtën kohë rolin e Gjirokastrës si një qendër e turizmit rajonal dhe portë drejt destinacioneve turistike të vendit.

Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja dhe promovimi i mjedisit kulturor të Bashkisë dhe të trashëgimisë kulturore (numër i madh vendesh me interes historik dhe kulturor, qyteti i vjetër i Gjirokastrës- monument UNESCO), me qëllim rivitalizimin turistik të rajonit.

Objektivi Strategjik 3: Rigjenerimi ekonomik i zonës, i udhëhequr nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, nëpërmjet zgjerimit të bazës prodhuese dhe të zhvillimit të balancuar të tre sektorëve të prodhimit. Përveç sektorit të turizmit, Bashkia e Gjirokastrës siguron prodhime të rëndësishme bujqësore dhe aktivitete industriale, sektorë të cilët duhet gjithashtu të stimulohen. Prodhimi bujqësor është veçanërisht i rëndësishëm, duke marrë parasysh pozicionin e saj, përshkrimin e Bashkisë nga lumi Drino dhe tokat bujqësore afër tij kanë produktivitet të lartë. Në të njëjtën kohë ka edhe një sektor të fuqishëm industrial i cili është përqëndruar kryesisht përgjatë autostradës SH4.

Objektivi Strategjik 4: Mbrojtje dhe menaxhim i qëndrueshëm i mjedisit natyror, nëpërmjet evidentimit të elementëve të fortë të Bashkisë (zona e mbrojtur Kardhiq, monumente natyrore, sipërfaqe pyjore) dhe mbrojtje si e sistemeve të ujërave sipërfaqësore dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

nëntokësore (burime, lumi Drino, liqeni Viroi), edhe të sistemit të tokës natyrore dhe bujqësore nga aktivitetet njerëzore.

Objektivi Strategjik 5: Përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve, nëpërmjet përmbushjes së infrastrukturës teknike dhe krijimit të një niveli të lartë të infrastrukturës sociale. Paralelisht duhet të jepen mundësi më të mira punësimi dhe të ketë një rigjallërim të qytetit të Gjirokastrës nëpërmjet rigjenerimit urban.

Projekt-buxheti-afatmesëm është instrumenti financiar 3 vjecar që ndërthur Planin e Përgjithshëm Vendor (një dokument strategjik 15 vjecar) me buxhetin vjetor. Si rezultat i zhvillimit strategjiko-financiare programi buxhetor afatmesëm 2020-2022 është hartuar mbi objektivat, politikat dhe planet strategjike afatmesme të bashkisë të përcaktuara në PPV.

➤ **Formulari F. 1 “Burimet buxhetore”**

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës të pakushtëzuar nga pushteti qendror. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Bashkëpunimi i administratës së tatim taksave në bashki me komunitetin do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, me qëllim realizimin e objektivave madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të bashkisë.

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

përafruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve.

Numri total i familjeve që parashikohet të përfshihet në skemën e detyrimeve fiskale është 8.596 familje. Për 1.026 familje janë parashikuar lehtësi fiskale për shkak të problemeve sociale. Bazuar në rregjistrin aktual, në total, numri i bizneseve që parashikohen të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale është 1.454.

Biznesi i vogël zë 81% të numrit total, gjithashtu në detyrimet fiskale përfshihen edhe 39 institucione buxhetore. Peshën më të madhe të taksapaguesve e përbëjnë bizneset, kjo për faktin se ka pak familje rezidente në territorin e bashkisë.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat priten të rriten në tre vitet në vazhdim për shkak të përmirësimit të strategjisë në mënyrën e mbledhjes së detyrimeve fiskale, impaktet e ndryshimeve ligjore të cilat bënë të mundur konsolidimin e ideologjisë së aplikimit të tarifave nga pushteti vendor. Gjithashtu një faktor i rëndësishëm është planifikimi i mbështetur në shpërndarje sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin e nivelit të tarifës sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar subjektin tatimpagues sipas taksimit të diferencuar. Ndërgjegjësimi bizneseve dhe qytetareve ndaj detyrimeve fiskale është një tjetër faktor i rëndësishëm. Të ardhurat për frymë janë llogaritur mbi numrin e përgjithshëm të banoreve të Bashkisë Gjirokastrë dhe Njësi Administrative të marrë nga Zyra e Gjendjes Civile, i cili është 52.140 banorë.

Rritja, rimëkëmbja ekonomike dhe pavarësia e njësisë së qeverisjes vendore është sfida kryesore e Bashkisë Gjirokastrë. Me politikat fiskale ne synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuara në planet tona strategjike me afatgjatë. Eksperienca, përballja me sfidat dhe problematikat, konsultimet me ekspertë dhe grupe interesi, por edhe vizioni i qartë i institucionit tonë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar, vijnë të konkretizuara me hartimin e kësaj pakete.

Kësisoj, planifikimi është mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore bazuar edhe në punën e bërë në terren për vitin 2019, duke bërë përcaktimin e nivelit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

tarifës sipas llojit të aktivitetit, sipas vendndodhjes gjeografike, duke lehtësuar bizneset, duke bërë një taksim sa më pak të diferencuar dhe zgjerimin e bazës tatimore.

Promovimi i territorit me vlerat e veta turistike, të trashëgimisë, artit, kulturës e traditës do të ndihmojë rritjen e ekonomisë. Bashkia Gjirokastrë tashmë është bërë pjesë e disa projekteve. Një prej projekteve të suksesshëm, ku bashkia po zbaton në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës Fondacionin Shqiptaro-Amerikan dhe TID-Gjirokastra, është rikonstruksioni i Pazarit Karakteristik dhe Zonës Muzeale (Faza e II e cila përfshin 81 biznese). Suksesi i këtij projekti, na krijon mundësinë e shqyrtimit të një projekti të ri (BID) për zgjerimin e zonës së investimit në lagjet e tjera të qytetit. (lagja “18 Shtatori”)

Nga ana tjetër, agroturizmi dhe prodhimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale janë një aspekt tjetër i rëndësishëm i ekonomisë në Gjirokastrë. Zonat e prodhimit bujqësor dhe blegtoral në Gjirokastrë, edhe pas disa investimeve të kryera në Njësitë Administrative, përballen me nevojën e madhe për mirëmbajtje dhe investime të tjera në kullim, vaditje, përmirësimin dhe krijimin e lërave të reja, mbjelljen e druve pyjore, përmirësimin e fondit pyjor, hartimin e planeve të menaxhimit të fondit kullësor dhe pyjor. Këto katër vite pas zbatimit të Reformës Administrativo- Territoriale, kanë treguar se ndryshimet e ndjeshme në sipërfaqe, numër popullsie, por edhe shërbime, kërkojnë angazhim më të mirë në përdorimin e fondeve.

Këto ndryshime po pasohen edhe me rikonceptime e ndryshime ligjore e nënligjore, si për organizimin e qeverisjes, buxhetimit, sistemit fiskal e për të gjitha fushat të cilat i kanë kaluar në funksion të këtyre njësive. Të gjitha këto ndryshime që janë bërë në vazhdimësi do të shërbejnë si instrument për rritjen e efikasitetit administrativ, profesional dhe teknik të qeverisjes vendore, nëpërmjet rritjes së të ardhurave, për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët.

Nivelet e taksave vendore, janë kryesisht të miratuara me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, por për nevojat e qeverisjes vendore dhe në konsultim me komunitetin, Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë edhe taksa të përkohshme, që i shërbejnë një objektivi të caktuar për përmirësimin e situatave në infrastrukturë e territorin brenda juridiksionit të bashkisë.

Burimet e financimit të Bashkisë Gjirokastrë përbëhen prej të ardhurave nga taksat e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

tarifat vendore të Njesisë Administrative Gjirokastrë dhe gjashtë Njësi Administrative të tjera, duke përfshirë dhe donacionet e ndryshme si dhe të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar dhe e kushtëzuar, fonde të cilat nuk reflektohen në këtë paketë fiskale.

Krahasimi i parashikimit të të ardhurave përgjatë 3 viteve të fundit tregojnë rritje të lehtë të të ardhurave, si rezultat i ndryshimit të legjislacionit fiskal, por edhe si rezultat i përmirësimit të treguesve të administrimit të sistemit fiskal të bashkisë dhe faktorë të tjerë të brendshëm dhe të jashtëm.

(F1) BURIMET BUXHETORE							
		2017	2018	2019	2020	2021	2022
		Viti t-2	Viti i shkuar	Viti aktual	Viti aktual	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)
A	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	145,967	166,605	201,548	204,265	209,362	213,968
A.1	TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE	40,606	43,222	58,348	54,318	55,115	55,734
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	1,559	1,993	2,066	2,741	2,768	2,796
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	31,014	30,829	46,515	44,051	44,581	45,027
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	23,536	25,319	37,216	35,915	36,274	36,637
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	4,081	4,335	7,011	6,982	7,122	7,193
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	-	100	325	317	324	327
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	3,397	1,075	1,963	837	862	870
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	957	922	1,045	892	937	946
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	6,440	8,764	8,042	6,204	6,390	6,518
A.1.5	Taksa e tabelës	6	5	-	0	0	0
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llotaritë vendore	-	-	-	0	0	0
A.1.7	Taksa e përkohëshme Takse rregjistrim subjekt I ri	630	709	680	430	438	447
A.1.8	Taksa e përkohëshme bbb	-	-	-	0	0	0
A.1.9	Taksa e përkohëshme ccc	-	-	-	0	0	0
A.2	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA (GRANTE)	12,763	18,083	17,725	20,987	21,616	22,265
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	-	-	-	0	0	0
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	12,763	18,048	17,725	20,987	21,616	22,265
A.2.3	Taksa e rentës minerare	-	-	-	0	0	0
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	-	-	-	0	0	0
A.2.5	Taksa të tjera	-	35	-	0	0	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

A.3	TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE	79,770	86,313	102,397	97,920	101,233	104,732
A.3.1	Tarifa me menaxhimin të mbetjeve	27,710	29,297	38,292	34,433	35,466	36,641
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	27,710	29,297	15,279	12,762	13,145	13,540
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	-	-	2,040	2,060	2,122	2,196
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	-	-	20,973	19,610	20,198	20,905
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-	0	0	0
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	19,211	21,585	27,404	24,185	25,112	25,866
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	19,211	21,585	15,278	12,577	12,954	13,343
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	-	-	1,020	1,020	1,040	1,072
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	-	-	11,106	10,588	11,118	11,451
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	2,744	3,403	3,480	3,720	3,906	4,101
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	2,744	3,403	3,480	3,720	3,906	4,101
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	-	-	-	0	0	0
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	-	-	-	0	0	0
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	16,540	17,628	17,363	18,430	19,028	20,018
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	660	1,248	1,210	1,381	1,394	1,464
A.3.5.2	Tarifa për dhënie e licensave, lejeve e autorizimeve	1,060	373	613	510	520	531
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	184	514	322	800	840	882
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	152	463	488	600	612	642
A.3.5.5	Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit	-	-	-	0	0	0
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licensuara dhe vendparkime publike	2,879	2,588	3,163	3,252	3,414	3,585
A.3.5.7	Tarifa për dhënie license për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	-	-	-	0	0	0
A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat	4,320	5,658	4,236	4,650	4,766	5,052
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrefiksja	631	436	361	750	787	827
A.3.5.10	Tarifa për zënie dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	6,224	5,998	6,578	5,924	6,102	6,407
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	-	0	0	0
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	-	-	-	0	0	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	430	350	392	564	593	628
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	11,864	12,744	14,356	13,733	14,131	14,337
A.3.6.1	Biblioteka	-	-	-	0	0	0
A.3.6.2	Muzeumet	4,284	5,545	6,732	6,173	6,420	6,549
A.3.6.3	Teatri	-	-	-	0	0	0
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-	-	0	0	0
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	-	0	0	0
A.3.6.6	Qendra Komunitare	-	-	-	0	0	0
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	-	-	-	0	0	0
A.3.6.8	Kopshtet	-	-	-	0	0	0
A.3.6.9	Çerdhet	7,580	7,199	7,624	7,560	7,711	7,788
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	3	58	-	0	0	0
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	65	98	-	0	0	0
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	-	-	-	0	0	0
A.3.10	Tarifa të tjera	1,633	1,500	1,502	3,418	3,589	3,769
A.4	TË ARDHURAT E TJERA	12,828	18,987	23,078	31,041	31,398	31,237
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	3,548	7,392	9,362	9,678	9,872	9,678
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	0	0	0
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-	0	0	0
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	0	0	0
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-	0	0	0
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-	0	0	0
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	102	600	-	500	662	695
A.4.8	Sekuestime dhe Zhdëmtime	-	-	-	0	0	0
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-	0	0	0
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-	0	0	0
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	-	-	-	0	0	0
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	-	-	-	0	0	0
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	-	-	-	0	0	0
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	-	-	-	0	0	0
A.4.14	Të tjera	9,178	10,995	13,716	20,863	20,864	20,864
B	TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	535,615	368,764	427,894	399,435	411,767	426,868
B.1	Transferta e pakushtëzuar	180,176	197,092	205,772	210,664	237,290	252,391
B.2	Transferta e kushtëzuar	338,951	164,184	214,483	181,132	166,838	166,838
B.2.1	Për funksionet e deleguara	149,495	164,184	165,003	166,838	166,838	166,838
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	189,456	-	49,480	14,294	0	0
B.3	Trasferta specifike	16,488	7,488	7,639	7,639	7,639	7,639
C	HUAMARRJA	-	-	-	-	-	-
C.1	Huamarrja afatshkurtë	-	-	-	-	-	-
C.2	Huamarrja afatgjatë	-	-	-	-	-	-
D	TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR	318,402	205,231	102,190	48,416	-	-
D.1	Trashëgimi pa destinacion	66,835	67,248	81,209	48,416	-	-
D.2	Trashëgimi me destinacion	251,567	137,983	20,981	-	-	-
	TOTALI I BURIMEVE BUXHETORE	999,984	740,600	731,632	652,116	621,129	640,836



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR**

Duke u bazuar te tabela nr.1, dalim në perfundimin se realizimi ndër vite ka ardhur duke u rritur, përkatësisht në vitin 2017 kemi një arritje të planit në masën 82 %, duke përfshirë dhe zërin Tatim i Thjeshtuar mbi fitimin, i cili prej vitit 2014 është përgjegjës për vlerësimin dhe mbledhjen Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë. Përsa i përket vitit 2018 realizimi është në masën 90 % . Duket qartë tendenca e rritjes së mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, e cila vjen për shkak të ristrukturimit të Agjencisë së të Ardhurave si dhe rritjen e performancës së kësaj Agjencie, duke bashkëpunuar me Agjencitë dhe Drejtoritë e tjera. Kjo tendencë parashikohet të mbahet edhe për vitin 2019 u përmirësuar në vitet në vazhdim.

A. Të ardhurat nga burimet e veta vendore

Të ardhurat nga burimet e veta vendore llogariten në 201,548 mijë lekë. Ato përfshijnë të ardhurat nga taksat, të ardhurat nga tarifat dhe të ardhurat nga burime të tjera. Pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë të ardhurat jo tatimore (55%).

Zërat e taksave dhe tarifave që ndikojnë pjesën më të madhe të planit të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2019-2020-2021-2022 janë kryesisht: Taksa mbi ndërtesën që zë rreth 18.6 %, tarifa e ndriçimit që zë 13,7 %, taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 4 %, tarifa për pastrimin që zë rreth 19 %, taksa e mjeteve të përdorura që zë rreth 9 % etj. Këto 5 zëra kryesorë mbulojnë rreth 64 % të planit të të ardhurave të Bashkisë Gjirokastrë.

Pesha kryesore në planifikimin e të ardhurave i ngarkohet Njesisë Administrative qytet Gjirokastrë në vlerën 167,422 mijë Lekë, ose 83.7 % të planit total të të ardhurave.

Kapacitetet fiskale të taksapaguesve

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet në të gjitha Njësitë Administrative. Bazuar në regjistrat aktualë, në total, numri i bizneseve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR**

Bashkisë Gjirokastrë është 1,401. Biznesi i vogël zë 82 % të numrit total të bizneseve. Numri i institucioneve që përfshihen në detyrimet fiskale janë rreth 39.

Në total numri i familjeve që parashikohet të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale të Bashkisë Gjirokastrë është 8,598 familje.

Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëttimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve.

Në planin e të ardhurave janë parashikuar lehtësi fiskale për familjet me probleme sociale, si për invalidët, të verbër, paaftësi, paraplegjikë etj, të cilët përbëjnë rreth 1,406 familje. Në bizneset e mëdhenj vihet re pesha e madhe që zë aktiviteti tregtar dhe shërbime me 61 % ndaj totalit të bizneseve të mëdhenj.

TAKSA MBI PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbehet nga:

- Taksa mbi ndërtesat
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Taksa mbi ndërtesen

- Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave.
 - Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.
 - Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

- Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
- Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.
- Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:
 - a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
 - b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
 - c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
- ✓ Per individët të cilët nuk kanë dorëzuar vërtetimin hipotekor ose nuk është kryer verifikimi në terren për ndërtesat e banimit para vitit 1993, do të aplikohet për efekt të përlllogaritjes së detyrimit një sipërfaqe fikse 70 m². (Qytet)
- ✓ Per individët të cilët nuk kanë dorëzuar vërtetimin hipotekor ose nuk është kryer verifikimi në terren për ndërtesat e banimit para vitit 1993, do të aplikohet për efekt të përlllogaritjes së detyrimit një sipërfaqe fikse 100 m². (Qytet)
- ✓ Per individët të cilët nuk kanë dorëzuar vërtetimin hipotekor ose nuk është kryer verifikimi në terren për ndërtesat e banimit, do të aplikohet për efekt të përlllogaritjes së detyrimit një sipërfaqe fikse 70 m². (Nj.Adm)
- ✓ Per subjektet individ, person fizik ose juridik për të cilët nuk kanë dorëzuar vërtetimin hipotekor ose nuk është bërë verifikimi në terren, do të aplikohet mënyra e vjetër e taksimit.
- ✓ Niveli i taksës për subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në Bashkinë Gjirokastrë do të jetë 185 lekë/m², ku të gjitha përlllogaritjet do të bëhen në bazë të metodologjisë së kadastrës fiskale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

- ✓ Niveli i taksës mbi ndërtesat për Nj.Administrative do të ulet në masën 35% mbi çmimin e referencës dhe 30 % ulje mbi shkallën e taksimit.

Tabela nr. 9 Krahësimi i planit 2018-19 në lidhje me taksën e ndërtesës

NR	NJESITE ADMINISTRATIVE (Taksa e ndertesës)	PLANI		Diferenca ne planifikim
		2018	2019	
1	GJIROKASTER	6.240 Lekë	12.480 Lekë	6.240 Lekë
2	ODRIE	79 Lekë	279 Lekë	200 Lekë
3	ANTIGONE	240 Lekë	479 Lekë	240 Lekë
4	LUNXHERI	256 Lekë	601 Lekë	345 Lekë
5	PICAR	93 Lekë	251 Lekë	158 Lekë
6	LAZARAT	254 Lekë	912 Lekë	658 Lekë
7	CEPO	264 Lekë	554 Lekë	290 Lekë
TOTAL		7.426 Lekë	15.557 Lekë	8.132 Lekë

Tabela tregon një rritje të planit për taksën mbi ndërtesat me një vlerë 8,132 mijë lekë.

Detyrimi për taksën e ndërtesës është vjetor. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë.

“Agjent tatimor për vjeljen e taksës për ndërtesat të cilat përdoren për qëllime banimi, është Ujësjellës-Kanalizime Sh.a, ndërsa për të gjithë subjektet e tjera strukturë e ngarkuar është Agjencia e të Ardhurave”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Taksa Mbi Tokën Bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, Janë si më poshtë:

Kategoritë e tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	2.800
II	2.100
III	1.400
IV	1.350
V	1.250
VI	1.200
VII-X	1.100

Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

“Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Agjencia e të Ardhurave pranë Bashkisë Gjirokastrë”.

Taksa Mbi Truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR**

vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen jepen në tabelën e mëposhtme.

TAKSA TE TJERA VENDORE

Tatimi I Thjeshtuar Mbi Fitimin

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to:

- të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5 për qind. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.

“Struktura e ngarkuar për vjeljen e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Taksa e Ndikimit ne Infrastrukture nga Ndertimet e Reja

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Më poshtë prezantojmë vetëm ndryshimet e bëra te taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifat e ndryshme të ndërtimit:

Shënim: Nga niveli 8 % i taksës së ndikimit në infrast.për ndërtimet e reja, 1 % e saj do të shkojë si fond për familjet në nevojë që ngelen jashtë nga lista sipas pikëzimit nga sistemi. Në buxhet do të përcaktohet një fond i veçantë për këtë kategori familjesh.

“Struktura e ngarkuar për përlllogarritjen e taksave dhe tarifave të mësipërme është Drejtoria e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit te Territorit.”

TAKSAT E TARIFAT TE VENDOSURA TE REJA OSE QË KANË PËSUAR NDRYSHIME NË PAKETËN FISKALE 2019

- ✓ Tarifa për pasuritë shtetërore që jepen me qera për truall (V.K.M nr. 54, dt. 05.02.2014) do të jetë 100 lekë/m²/vit. (Struktura përgjegjëse -Agjencia e të Ardhurave, Zyra e Pronave)
- ✓ Licencë për kryerjen e shërbimeve në linjë te rregullt rrethqytetëse – 40.000 lekë për një afat 10 vjeçar. (Struktura përgjegjëse- Zyra e Shërbimeve)
- ✓ Tarifë shërbimi për asgjësimin e produkteve dhe mallrave ushqimore etj. të skaduara – 0.2 % mbi vlerën e mallrave që do të asgjësohet (Struktura përgjegjëse- Zyra e Shërbimeve)
- ✓ Tarifë parkimi 1-vjeçare për taksitë dhe linjat e shërbimit urban dhe rrethqytetës – ishte 3.000 lekë do të bëhet 4.000 lekë/vit për çdo mjet.
- ✓ Certifikatë dublikatë – ishte 500 lëke bëhet 1.000 lekë/shërbim
- ✓ Lëshim vërtetimi për efekt tenderi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

-B.Vogël ishte 500 lekë bëhet 1.000 lekë
-B.Madh (në bazë të formularit të vlerësimit) ishte 1.000 bëhet 4.000 lekë

- ✓ Lëshim dokumentacioni nga arkivi – ishte 200 bëhet 100 lekë/faqe
- ✓ Lëshime dokumentacioni nga arkivi në mënyrë elektronike –ishte 100 bëhet 50 lekë/faqe

- Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisit
Tarifat për kullotat do të ndryshojnë si më poshtë:

	Ishte	Behet
- Kullote dimerore per dhen	150 leke/krere	100 leke/krere
- Kullote dimerore per dhi	150 leke/krere	100 leke/krere
- Kullote verore per dhen	150 leke/krere	100 leke/krere
- Kullote verore per dhi	150 leke/krere	80 leke/krere
- Pyje qe kulloten per dhen	100 leke/krere	50 leke/krere
- Pyje qe kulloten per dhi	150 leke/krere	100 leke/krere
- Prerje gjethe	40 leke/vandak	10 leke/kv

“Struktura e ngarkuar për vjeljen e kullotave është Agjencia e Shërbimit Bujqësor, Veterinar dhe Mjedisit, pranë Bashkisë Gjirokastrë”.

➤ **Taksat dhe tarifat për familjet me lehtësi fiskale**

Bashkia Gjirokastrë në kuadrin e mbledhjes së të ardhurave dhe shpërndarjen e tyre është treguar e kujdesshme jo vetëm në shërbime dhe investime, por dhe në trajtimin e familjeve me lehtësi fiskale:

- ✓ për personat të cilët gjatë vitit kalendarik klasifikohen në listën e personave me të ardhura nën nivelin minimal jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivelin kombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

- ✓ Për personat me aftësi të kufizuara, invalidë, tetraplegjikë dhe paraplegjikë, të verbrit kur njëri nga kryefamiljarët (bashkëshorti/bashkëshortja) dhe nuk kanë persona të tjerë madhorë në familje me përjashtim të bashkëshortit/bashkëshortes.

Taksat dhe tarifatat për këtë kategori shoqërore do të **zerohen**.

Më konkretisht:

- 1) **Tarifa e pastrimit** - nga 150 lekë/muaj do të shkojë në 0 lekë/muaj.
- 2) **Tarifa e ndriçimit** - nga 150 lekë/muaj do të shkojë në 0 lekë/muaj.
- 3) **Tarifa e gjelbërimit** – për individët invalidë do të shkojë në vlerën 0 lekë/muaj.
- 4) **Tarifa e infrastrukturës për arsim, sport, kulturë** – do të shkojë në vlerën 0 lekë/muaj
- 5) Gjithashtu këto familje nuk do të paguajnë tarifatat për shërbimet që ofron Bashkia si psh:
 - Deklaratë e paraqitjes mujore të familjes – do të bëhet 0 lekë
 - Deklaratë e gjendjes ekonomike dhe sociale të familjes – do të bëhet 0 lekë
 - Librezë ndihmë ekonomike – do të bëhet 0 lekë
 - Të dhëna të tjera sociale të familjes – do të bëhet 0 lekë
 - Vërtetimet për shërbime të ndryshme
 - Krijimi i fondit për familjet në nevojë që ngelen jashtë nga lista sipas pikëzimit nga sistemi (Nga niveli 8 % i taksës së ndikimit në infrast.për ndërtimet e reja, 1 % e saj do të shkojë si fond për familjet në nevojë që ngelen jashtë nga lista sipas pikëzimit nga sistemi. Në buxhet do të përcaktohet një fond i veçantë për këtë kategori familjesh).
 - Përcaktimi i një fondi të veçantë për ushqimin dhe edukimin e 85 fëmijëve romë dhe egjiptinë, në kopshtin “Shpresa Dema”, në lagjen “Zinxhira” dhe kopshtin “Rreze Drite”, lagja “Punetore”, si dhe transportin e 86 nxënësve romë e egjiptianë në shkollën “Çajupi” dhe “Koto Hoxhi”.

Gjatë vitit 2019 e në vazhdim do të punohet për të marrë në konsideratë edhe kategori të tjera me të ardhura nën nivelin minimal jetik. **Efektin negativ** që sjell në çdo zë të të ardhurave, si pasojë e uljes së taksave dhe tarifave për invalidët, të verbër, të paafte dhe paraplegjikë shkon në shumën 6,749 mijë lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

➤ **F6, F7 Shpërndarja e shpenzimeve sipas funksionit ”**

Planifikim, menaxhim dhe administrim (programi 01110) Aparati i bashkisë funksionon me programin 01110 i cili mbulon shërbimet mbështetëse për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose këshillin. Siguron planifikimin e zhvillimit të njësisë, menaxhimin e financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera të njësisë dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun. Për vitin 2020 aparati i Bashkisë do të menaxhojë në total 43% të buxhetit 2020 në programet buxhetore si më poshtë :

- Shpenzimet për paga dhe sigurime 600+601
- Shpenzimet operative 602-609
- Shpenzime kapitale 230+231

Programi mbulon shërbimet mbështetëse si më poshtë:

- *Komunikimi i Kryetarit ose Këshillit me publikun.*
- *Menaxhimi i fondeve të njësisw tw vetëqeverisjes vendore*
- *Menaxhimi i aktiveve të njësisë*
- *Planifikim, menaxhim dhe shpërndarje e njëtrajtshe e skemave fiskale*
- *Organizimi i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik të bashkisë.*
- *Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet.*
- *Parandalimin e kundravajtjeve administrative, si dhe parandalimin e ndërtimeve pa leje, ndryshimeve të fasadave etj.*
- *Menaxhim me efektivitet të transportit publik në qytet dhe njësitë administrative.*
- *Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale ne nivel vendor për shtresat në nevojë.*
- *Mbrojtja civile nëpërmjet administrimit të strukturave përkatëse.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

	2020	2021	2022
	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
Pagat dhe sigurimet shoqërore	87,300	87,300	87,300
Të tjera shpenzime korrente	46,773	46,576	46,576
Shpenzimet kapitale	34,560	13,236	20,000
Tavanet e përgjithshme	168,633	147,112	153,876
Angazhimet kujtesë	14,279	0	0

Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi (programi 032)

Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi është një funksion i transferuar nga pushteti qendror dhe si i tillë funksionon me grant specifik dhe me të ardhurat nga Bashkia. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, pronës, mjedisit, pyjeve, kullotave, aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu.

- Administrimi i parandalimit të zjarrit dhe problemeve të shërbimeve të mbrojtjes kundër zjarrit.
- Funksionimi i njësive të zakonshme dhe njësive ndihmëse zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit të mbajtura nga autoritetet publike.
- Funksionimi ose mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

	2020	2021	2022
	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
Angazhimet kujtesë	0	0	0
03280	Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	26,960	26,960	26,960
Të tjera shpenzime korrente	5,175	5,175	5,175
Shpenzimet kapitale	0	0	0
Tavanet e përgjithshme	32,135	32,135	32,135
Angazhimet kujtesë	0	0	0

Tredni i ndërhyrjeve në raste zjarri dhe shpëtimi vjen duke u ulur kjo për faktin e krijimit të dy qendrave të tjera zjarrfikëse, një në Bashkinë Libohovë dhe një në Bashkinë Dropull. Në zbatim të VKM NR.707, datë 12.10.2016 MZSH ka asistuar në situata zjarri edhe në Bashkitë fqinje.

Shërbimet Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore (programi 042)

Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore është një funksion i transferuar nga pushteti qendror dhe si i tillë funksionon me grant specifik dhe me të ardhurat nga Bashkia. Misioni i agjencisë është menaxhimi i rezervave pyjore dhe shfrytëzimi racional i këtyre rezervave, sistemimi i kanaleve ujitëse dhe kontrolli i përmbytjeve.

Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit (programi 04240)

- *Evidentimi dhe ndjekja në vazhdimësi e problematikave për sistemimin e kanaleve ujitëse.*
- *Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve ujore.*
- *Rehabilitimi i kanaleve vaditëse.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

- *Mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.*

	2020	2021	2022
	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
04240	Menaxhimi i Infrastrukturuës së ujitjes dhe kullimit		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	7,502	7,502	7,502
Të tjera shpenzime korrente	4,725	4,725	4,725
Shpenzimet kapitale	0	1,450	2,000
Tavanet e përgjithshme	12,227	13,677	14,227
Angazhimet kujtesë	0	0	0

Menaxhimi i pyjve dhe kullotave (programi 04260)

- *Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e resurseve pyjore.*
- *Administrimi dhe menaxhimi i kullotave.*
- *Zgjerimi dhe shfytëzimi i racionalizuar i rezervave pyjore*
- *Organizim dhe mbështetje për veprimtarinë e ripyllëzimit*
- *Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e tyre*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

	2020	2021	2022
	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	8,357	8,357	8,357
Të tjera shpenzime korrente	1,870	1,870	1,870
Shpenzimet kapitale	3,000	4,550	5,000
Tavanet e përgjithshme	13,227	14,777	15,227
Angazhimet kujtesë	0	0	0

Shërbimet Publike (programi 062)

Agjencia e Shërbimit Publik në varësi të Bashkisë ka ndërtuar punën në bazë të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeversijen Vendore“ dhe në bazë të Udhëzimeve të herë pas hershme të nxjerra nga Bashkia Gjirokastrë. Agjencia e Shërbimeve Publike funksionon me dy programe buxhetore 06260 dhe programi 04520. Kjo agjenci administron 20% të buxhetit të bashkisë për vitin 2020 si më poshtë vijon:

Shërbimet Publike (programi 06260)

- ❖ *Mbledhja, largimi i mbetjeve dhe pastrimi i hapësirave publike në qytet.*
- ❖ *Gjelbërimi i hapësirave publike duke mbjellë pemë, lule sezonale.*
- ❖ *Nërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike.*
- ❖ *Mirëmbajtje të ndricimit rrugor, rritja e rrjetit.*
- ❖ *Dekor i qytetit sipas rastit.*

Mirëmbajtja e rrugëve rurale (programi 04520)

- ❖ *Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtje e trotuareve, rrugëve rurale.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

		2020	2021	2022
		Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
04520	Rrjeti rrugor rural			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		6,027	6,027	6,027
Të tjera shpenzime korrente		5,800	5,800	5,800
Shpenzimet kapitale		3,439	14,676	10,000
Tavanet e përgjithshme		15,266	26,503	21,827
Angazhimet kujtesë		4,500	0	0

Referuar programit 06260 në programin e investimeve është parë e arsyeshme që projekti “Rikonstruksioni i rrugës midis Policisë dhe Gjykatës” të kryhet në vitin buxhetor 2020, ndryshe nga sa ishte parashikuar në vitin 2022.

		2020	2021	2022
		Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
06260	Sherbime publike vendore			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		86,853	86,853	86,853
Të tjera shpenzime korrente		41,525	42,442	42,442
Shpenzimet kapitale		36,781	16,562	23,860
Tavanet e përgjithshme		165,159	145,857	153,155
Angazhimet kujtesë		0	0	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Kultura, Trashëgimia, Turizmi dhe Sportet (programi 081)

Agjencia e Kulturës, Trashëgimisë, Turizmit dhe Sporteve funksionon në vartësi të Bashkisë Gjirokastrë në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në mbështetje të udhëzimeve të herë pas hershme të nxjerra nga bashkia. Kjo agjenci ka në përbërje të saj dy programe buxhetore 08140 Klubet Sportive, dhe 08280 muzet, teatrot dhe ngjarjet kulturore.

- ❖ *Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore.*
- ❖ *Menaxhimi, mbrojtja dhe promovimi i monumenteve të kulturës.*
- ❖ *Organizimi i aktiviteteve kulturore.*
- ❖ *Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave publike.*
- ❖ *Organizimi i aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese.*

		2020	2021	2022
		Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
08130	Sport dhe argëtim			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		4,254	4,713	4,760
Të tjera shpenzime korrente		250	260	265
Shpenzimet kapitale		5,300	0	0
Tavanet e përgjithshme		9,804	4,973	5,025
Angazhimet kujtesë		0	0	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

		2020	2021	2022
		Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		22,810	22,810	22,810
Të tjera shpenzime korrente		14,550	14,550	14,550
Shpenzimet kapitale		0	0	0
Tavanet e përgjithshme		37,360	37,360	37,360
Angazhimet kujtesë		0	0	0

Arsimi parashkollor (programi 09120)

- ❖ *Menaxhimi, administrimi dhe mirëmbajtja e godinave të arsimit parashkollor .*
- ❖ *Menaxhimi, administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor, kopshte dhe cerdhe.*
- ❖ *Menaxhimi dhe mirëmbajtja e ambienteve të godinës të cilat ofrojnë shërbime sociale „Qendra Ditore“*
- ❖ *Trajtimi ushqimor në programin parashkollor*

Arsimi parauniversitar (programi 09230)

- ❖ *Menaxhimi, administrimi dhe mirëmbajtja e godinave të arsimit parauniversitar.*
- ❖ *Zhvillimi i aktiviteteve edukuesve në nivel vendor.*
- ❖ *Trajtimi ushqimor në programin parauniversitar.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

	2020	2021	2022
	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	95,772	100,783	100,783
Të tjera shpenzime korrente	21,399	18,563	18,563
Shpenzimet kapitale	5,444	5,638	10,000
Tavanet e përgjithshme	122,615	124,984	129,346
Angazhimet kujtesë	0	0	0

	2020	2021	2022
	Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm		
Pagat dhe sigurimet shoqërore	27,065	22,054	22,054
Të tjera shpenzime korrente	18,749	18,749	18,749
Shpenzimet kapitale	0	5,000	10,000
Tavanet e përgjithshme	45,814	45,803	50,803
Angazhimet kujtesë	0	0	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

		2020	2021	2022
		Viti t+1 (I pritur)	Viti t+2 (I pritur)	Viti t+3 (I pritur)
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara			
Pagat dhe sigurimet shoqërore		7,344	7,344	7,344
Të tjera shpenzime korrente		729	729	729
Shpenzimet kapitale		0	0	0
Tavanet e përgjithshme		8,073	8,073	8,073
Angazhimet kujtesë		0	0	0

Kujdesi Social (programi 010140)

- ❖ *Krijimi administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.*
- ❖ *Administrim, vënie në funksion ose mbështetje për skemat e mbrojtjes shoqërore.*
- ❖ *Përfitime në natyrë: si vakte ushqimi që i jepen personave të paafte në ambiente të përshtatshme.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Referuar informacionit nga tabela lartpërmendur, shpenzimet për personelin janë mbajtur konstant, pavarësisht nevojave për shtesw të burimeve njerëzore si në programin 06260 në sektorin e pastrimit ku paraqitet një mungesë e madhe e fuqisë punwtore për të përballuar me pastrim sipërfaqen e madhe në të cilën ushtrohet funksioni i pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane. Duke marrë parasysh fondet buxhetore të limituara Bashkia e ka të pamundur të bëj rritje të fuqisë punwtore në sektorin e pastrimit të qytetit edhe pse është një domosdoshmëri.

Si rezultat i infrasktrukturës arsimore shumë të amortizuar planifikohen 16.602.000 Lekë për vitin 2022 dhe 5.638.000 Lekë për vitin 2021 për kryerjen e rikonstruksioneve të godinave arsimore parashkollor dhe 5.300.000 Lekë për rikonstruksionin e institucioneve arsimore parauniversitare. Përveç hartimit të projekteve për ndërhyrje në hidroizolim nuk është lënë jashtë vëmendjes edhe parashikimi për rikonstruksionin e ambienteve të brendshme të godinave arsimore.

Kërkesat në rritje për zhvillimin e bizneseve në zona të reja urbane ka sjellë parashikimin e fondit prej 6.000.000 Lekësh për hartimin e 5 planeve të detajuara vendore. Hartimi i planeve të detajuara vendore u hap rrugën shumë bizneseve të zhvillojnë aktivitetin e tyre në rritje. Si rezultat i rritjes së bizneseve parashikohet ndikimi pozitiv drejt për së drejti në të ardhurat e veta të bashkisë. Rëndësi i është kushtuar edhe ndërhyrjes për rikonstruksion në infrastrukturën rrugore në lagjet e reja të qytetit por edhe në lagjet ekzistuese.. Vitin e dytë të projekt buxhetit afatmesëm u është dhënë rëndësi vazhdimi i projekteve afatgjata në infrastrukturën arsimore, rrugore, dhe atij të ndriçimit rrugor. Në vitin e tretë të projekt buxhetit afatmesëm i është kushtuar vëmendje shpenzimeve kapitale në programin e “zhvillimit të komunitetit”, blerja e dy makinave teknologjike dhe e konteniervave të rinj.

Në infrastrukturën e pyje-kullotave për vitin 2020-2022 është parashikuar rikonstruksioni i “lerave” ekzistuese, ndërtimi i atyre të reja, rehabilitimi dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve pyjore të dëmtuara nga faktorë të ndryshëm. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e kanaleve kulluese dhe vaditëse është parashikuar çdo vit pothuajse në shumta të njëjta.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Në programin e transportit 045 “Mirëmbajtja e rrugëve rurale” është parashikuar të kryhet rikonstruksioni i rrugëve rurale kryesore në katër fshatra në shumën 31.500.000 Lekë për periudhën afatmesme 2020-2022.

Referuar informacionit sipas tabelës së shpërndarjes së shpenzimeve sipas programeve vihet re se programi 06260 “Shërbimet Publike” kryeson në shpenzimet operative. Kjo për vetë faktin se pranë kësaj agjencie janë adresuar shërbimet kryesore ndaj komuniteti, si pastrim, gjelbërim, ndricim rrugor, mirëmbajtje të rrugëve, rehabilitim dhe mirëmbajtje të parqeve, lulishteve dhe varrezave publike. Bashkia Gjirokastrë pas reformës territoriale trashëgoi nga ish-komunat një rrjet të dëmtuar të infrastrukturës rrugore dhe të ndricimit rrugor. Pjesa më e konsiderueshme e fshatrave ishin pa ndriçim rrugor dhe me infrastrukturë të dëmtuar rrugore. Duke marrë parasysh fondet e limituara dhe për t'i dhënë sa më shpejtë zgjidhje situatës së ndriçimit rrugor Bashkia Gjirokastrë ka mundur që me punën e agjencisë së Shërbimeve Publike të zgjerojë ndriçimin rrugor në rrjetin ekzistues në njësitë administrative me pjesët që zhvendosen nga zvendësimi i ndriçuesave me llampa të ngrohta në ndriçues me llampa led në lagjet e qytetit. Kjo është menduar si një efikasitet energjie në konsum dhe si një zgjidhje e përhershme e ndriçimit rrugor në fshatra me një kosto prej 2.015.000 Lekë për lidhjen e kontratave të reja të energjisë elektrike. Një shërbim tjetër që zë peshë të konsiderueshme është pastrimi i qytetit, mbledhja dhe largimi i mbetjeve. Duhet të theksohet se Bashkia Gjirokastrë trajtimin e mbetjeve urbane e bën me kontraktim të jashtëm. Sipërfaqja e madhe dhe relievi jo i njëtrajtshëm sjellin angazhim të konsiderueshëm për shërbimin e pastrimit. Megjithatë ky shërbim ofrohet në relieve të ndryshëm natyre është e njëjtë, pra ka të njëjtat baza kostoje. Nënkuptohet që janë të njëjtat burime njerëzore, të njëjtat mjete dhe materiale pune.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Treguesit financiar

Katër programet buxhetore si :Shërbimet Publike, Mirëmbajtja e Rrugëve Rurale, Arsimi Parashkollor dhe ai Parauniversitar zënë peshë të konsiderueshme në shpenzimet korente. Kjo për vetë faktin se janë programet që ofrojnë shërbimet më afër komunitetit. Shërbimet bazë të ofruara mbi këto programe mbështeten mbi shpenzimet korente. Një faktor tjetër që ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve korrente. Përsa u përketë detyrimeve të prapambetura duhet të permendet se shpenzimet gjyqësore të ardhura si veprimet administrative të viteve 2015 zënë një pjesë të konsiderueshme gati 12 milionë Lekë dhe për tre mujorin e parë të vitit 2019 janë shlyer gati 7 milion Lekë, për vitin 2020 janë planifikuar 12.000.000 Lekë për shlyerjen e një pjese të konsiderueshme të proceseve gjyqësore. Përvec vendimeve gjyqësore një peshë të konsiderueshme zënë edhe shpenzimet kapitale. Këto të fundit janë krijuar tre mujorin e fundit të viti 2018 dhe janë shlyer rreth 100 %.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

(F14) INDIKATORËT

		2017	2018	2019	2020	2021	2022
1	Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave						
	Shpenzimet e përgjithshme / Të ardhurat e përgjithshme	61.0%	98.7%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
2	Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore ndaj totalit të të ardhurave						
	Taksat dhe tarifat lokale / Të ardhurat e përgjithshme	12.0%	17.5%	22.0%	23.3%	25.2%	25.0%
3	Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave						
	Të ardhura nga burimet e veta / Të ardhurat e përgjithshme	14.6%	22.5%	27.5%	31.3%	33.7%	33.4%
4	Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve						
	Shpenzimet kapitale / Shpenzimet e përgjithshme				14.3%	10.0%	12.8%
5	Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale						
	Shpenzime korrente / Totali shpenzimeve				85.7%	90.0%	87.2%
6	Norma e shpenzimeve të personelit ndaj totalit të shpenzimeve						
	Shpenzimet e personelit / Shpenzimet e përgjithshme				60.7%	63.8%	61.8%
7	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj totalit të të ardhurave						
		0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
8	Norma e huamarrjes afatgjatë ndaj të ardhurave të veta						
		0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR**

(E3)LISTA EMERORE E PROJEKTEVE TE INVESTIMEVE

Emërtimi i projektit	Vlera e kontratës	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Rikonstruksioni i rrugices Kapo Baco ne lagjen Varrosh	7,627			3,300	3,353		
Rikonstruksioni i rruges prane kabines ne lagjen Manalat deri te "Govacajt"	4,997			4,997			
Shpronsime per familjen	4,400			4,400			
Blerje kazanesh per mbetjet urbane	5,800			5,800			
Nderhyrje ne infrastrukturen rrugore per permiresimin e levizshmerise se persona me PAK	900			900			
Masa inxhinerike per stabilizimin e rreshkitjes se mases ne Kodren e Shtufit, kontrata shtese	16,800			6,048	10,751		
Zgjerimi i ndricimit rrugor ne fshatra	7,000			2,500	3,439		
Sinjalistike rrugore	1,200			1,200			
Rehabilitim i skemave vaditese, vashdim	300			300			
TVSH per projektet me financim te jashtem	500			500			
Studime, projekte		340	2,718	7,852			
Mbyqirje, kolaudime			1,293	3,574			
Ndertimi i Tregut Industrial ne qytetin e Gjirokastrës, kontrata shtese	4,803		3,999	804			
Trajtimi i mbetjeje urbane ne vend depozitim Gerhot 2018-2019	2,451			2,451			
Implementimi i PDV	8,000				3,000	5,000	
Implementimi i sistemit te GIS-it	8,000						
Hartimi i projekt-studimeve mbi infrastrukturen rrugore dhe arsimore	11,200						10,000
Hartimi i projekt-studimeve mbi infrastrukturen rrugore	21,236				3,000	8,236	10,000
Rikonstruksioni i rruges per ne lagjen e "Teqes"	60,000					10,062	
Hartimi dhe implementimi i hartes dixhitale te pikave turistike ne Bashkine Gjirokastrë	16,000						4,336
Blerja e pajisjeve teknologjike	4,500					4,500	
Rikonstruksioni i rruges midis Policise dhe Gjykates Loti I I	16,036				11,200	4,836	
Rehabilitim i skemave vaditese dhe kulluese	2,000						2,000
Ndertimi i lerave te reja dhe rikonstruksioni i lerave ekzistuese	4,450				3,000	1,450	
Hartimi i planeve te menaxhimit te pyjeve	8,000					3,000	5,000
Hartimi i planeve te menaxhimit te pyjeve	8,000					3,000	5,000
Asfaltimi i rruges kryesore ne fshatin Cepune	5,000					5,000	
Rikonstruksioni i rruges per ne fshatin Golem	13,500					5,000	5,000
Rikonstruksioni i rruges se fshatit Arshi Lengo	13,000					4,676	5,000
Trajtimi i mbetjeje urbane 2019-2020	2,500						2,500
Blerja e dy makinave teknologjike	10,000						10,000
Rikonstruksion i shkollave "Se Bashku", "Bilal Golemi", Konvikti, QKF	15,000						11,360
Ndertimi i shkolles 9-vjecare	26,740						
Rikonstruksion i godinave te arsimit parashkollor	16,602				5,300	5,638	5,664
Rehabilitimi dhe pyllëzimi pjesor i siperfaqeve pyjore	1,550					1,550	
Rikonstruksioni i rrugës pranë "Govacajve"	8,501				8,501		
Ndertimi i mini parkut ne lagjen 11 Janari	4,681				4,681		
Ndertimi i mini parkut ne lagjen Zinxhira Manalat	3,731				3,731		
Rehabilitimi i ndricimit rrugor na lagjen zinxhira	2,015				2,015		
TVSH per projektet me financim te jashtem	2,000				2,000		
Rikonstruksion i fusher se vjeter dhe pallatit te sportit	5,300				5,300		
Rikonstruksioni i infrastruktures arsimore parauniversitar	15,000					5,000	10,000



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR**

Konkluzione

Hartimi i PBA 2020-2022 është në zbatim të procedurave të udhëzimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë si dhe me asistencë të projektit ‘SECO’ dhe specialistë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Janë marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e komunitetit, që kanë bërë të mundur vendosjen e prioriteteve.

Ndryshe nga faza e parë e PBA 2020-2022 kemi ulje buxheti si rezultat i uljes së trasfertës së pakushtëzuar të planifikuar nga 219.356.560 lekë në 210.664.000 Lekë dhe ulja e parashikimit të të ardhurave të veta nga 211.384.000 Lekë në 204.265.000 Lekë mbi bazën e realizimit të të ardhurave në 2019. Sic shihet investimet janë përqëndruar kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, rrugore, ujitjes dhe kullimit, pyje, kullotave dhe në strukturën e shërbimeve ndaj komunitetit. Investimet nga të ardhurat lokale janë parashikuar me rritje konstante.

K R Y E T A R

Flamur Golemi